



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK - NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % DHE NGA FONDET E DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL.

Të nderuar këshilltarë ,

Drejtoria e Shërbimit Social, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 8/2, 9 pika 1.1, gërma “b”, 21, 64 gërma “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021, kreu IV, pika 1, 2 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. si dhe VKM nr.8 datë 14.01.2015 i ndryshuar në datë 15.01.2019 “Për mbrojtjen e Shtresave në Nevojë, për efekt të heqjes së Fashës së Kompesimit të Energjisë Elektrike deri në 300 kwh në muaj” . VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 513, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rasti, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

JU RELATON :

I. Miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 % dhe nga fondet e drejtorisë së shërbimit social si më poshtë:

1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
2. Familje me kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.
4. Familjet ose individët që kanë një pension të ulët.
5. Familje me shumë fëmijë.
6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin arsimin bazë dhe universitar.
7. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftesi/invalidë pune.

8. Familje që kanë një anëtar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.
9. Familjet të rikthyera nga emigracioni ose azil kërkuese që i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe mazhorancë.
10. Familje shumë të varfëra që për arsyeje të ndryshme nuk arrijnë të aplikojnë sipas ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", këto familje do të trajtohen nga fondet e buxhetit vendorë duke vijuar si më poshtë :

- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike".
- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 date 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike".
- IV. Dokumentat e aplikuesve për piken 10 janë : Certificate familjare, fotokopjen e kartës së identitetit, vërtetim nga Njësia Administrative (vërtetim vendbanimi) ose SPZ e zonës ku banon, dokumenta të ndryshëm nga institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera vendore ose lokale, verifikime në sistemin e-albania çdo 3 (tre)-muaj dhe formularin e paraqitjes mujore Mod 2, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË N.E/PAK/INV

Evgjeni Pelivani



DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE ,TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

MBI MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE PËRFUNDIMTARE TË FAMILJEVE PËRFITUESE PËR PROJEKTIN " PËRMIRËSIM I KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA,VITI 2025" .

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat e ka prioritet të saj strehimin e familjeve në nevojë, të pa favorizuara e me probleme sociale .

Për ti ardhur ne ndihmë kësaj shtrese është viti i pestë që bashkia aplikon për tu bërë pjesë e projektit " Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të të varfëra dhe të pa favorizuara", duke qënë edhe bashkëfinacuese në masën 20% për vitet 2020 e 2021 dhe 30% për vitin 2022 e 2023 dhe për vitin 2025.

Bashkëfinancimi në masën 30% të koston totale të projektit për vitin 2025, bazohet në nivelin e të ardhurave vjetore për frymë i cili për vitin 2023 për Bashkinë Berat është 4,863 lekë , pra futemi te grupi i bashkite me të ardhura vjetore për frymë 4,001-6,000 lekë ,për rrjedhojë përqindja maksimale e financimit nga buxheti i shtetit është 70% e koston totale te projektit.

Grupi i punës i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.688 , datë 15.10.2024 bëri hartimin e projekteve dhe preventivave , të familjeve të cilat kanë aplikuar në sistemin e-albania për projektin " Përmirësim i kushteve të banimit të banesës së tyre " si dhe të familjeve qe kanë dorëzuar dokumentacionin në bashki ne rrugë shkresore .

Numri total i familjeve qe do te trajtohen me kete projekt jane 48 familje, kosto totale e projektit është në vlerën 51,200,412.30 lekë , ku 30% (15,360,123.69 lekë) e koston totale e projektit do të jete bashkëfinancim i bashkisë .

Kategoritë e familjeve përfituese pë këtë projekt sipas nenit 16 të ligjit 22/2018 "Për strehimin social" i nryshuar janë :

- Familje që kanë në përbërjen familjare persona me aftësi të kufizuar, invalid janë 10 .
- Familje nga Komuniteti Rom 8
- Familje nga Komuniteti Egjyptian 8
- Të moshuar 12 familje .
- Familje me ndihme ekonomike 12, ndërsa pjesa tjetër janë familje me të ardhura shumë të ulëta .

Drejtör i M.C.P.T.SH

Sokol TOSKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIM

RELACION

MBI MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIMIN E BASHKISË NË PROJEKTIN "PËRMIRËSIM I KUSHTEVE TE BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PËR VITIN 2025".

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat e ka prioritet të saj strehimin e familjeve në nevojë të pa favorizuara e me probleme sociale .

Për ti ardhur ne ndihmë kësaj shtrese prej tre vitesh Bashkia Berat është bërë bashkëfinacuese në masën në projektin " Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara".

Për vitin 2020 nga zbatimi i këtij projekti përfituan përmirësim të banesave 14 familje me kosto totale të projektit në vlerën 11,930,760 leke .

Për vitin 2021, përfituan përmirësim të banesave 36 familje me kosto totale të projektit në vlerën 33,347,697 leke .

Për vitin 2022, përfituan përmirësim të banesave 47 familje me kosto totale të projektit në vlerën 45,884,667 leke .

Për vitin 2023, përfituan përmirësim të banesave 63 familje me kosto totale të projektit në vlerën 73,753,420 leke .

Bashkia Berat edhe për këtë vit ju përgjigj pozitivisht kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë , Kulturës dhe Inovacionit "Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2025".

Nisur nga numri i madh i familjeve ne nevojë të identifikuar nga ana jonë, banesat e të cilave janë të amortizuara dhe jashtë kushteve teknike, ne edhe këtë vit po pregatisim dosjen për të aplikuar për këtë projekt.

Një nga kushtet që duhet të plotësojë Bashkia për t'u kualifikuar është përqindja e bashkëfinancimit për projektin, që për bashkinë është 30% e koston totale të projektit .

Bazuar në tabelën nr.2 " Kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit në varësi të nivelit të të ardhurave vjetore për fytyrë të cilat për vitin 2023" të termave të referencës të projektit për Bashkinë Berat , janë 4,863 mijë lekë dhe përqindja maksimale e financimit nga buxheti i shtetit është deri në 70% të koston totale të projektit dhe pjesa tjetër 30% do të mbulohet nga fondet e bashkisë.

Konkretisht për vitin 2025 kostoja totale e projektit është në vlerën 51,200,412.30 lekë dhe 30% i saj është në vlerën prej 15,360,123.69 leke .

Adresa:Blvd. "Republika", Berat 5001.Shqipëri,Tel /00355(0) 2 32 34 935,Website: www.bashkiaberat.gov.al, Email : bashkiaberat@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga sa më sipër, ne ju propozojmë të miratoni financimin në masën 30 % të kostos së projektit
“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”.

Drejtör i M.C.P.T.SH

Sokol TOSKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE ,PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

MBI MIRATIMIN E QIRASË MESATARE MUJORE TË BANESAVE NË TREGUN E LIRË

Të nderuar Këshilltare!

Bashkia Berat në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë ,Kulturës dhe Inovacionit si ministria përgjegjëse për strehimin ,për zbatimin e politikave të strehimit për familjet e pastreha, kanë planifikuar fonde për finacimin e bonusit të strehimit për vitin 2025, për qytetarët në nevojë për t'u strehuar , nisur dhe nga fakti që ka shumë familje të pastreha që kërkojnë dhe plotësojnë kriteret për përfitimin e bonusit të strehimit ,pasi ne nuk kemi banesa sociale të lira për tu ndarë .Ky projekt po zbatohet nga bashkia që prej vitit 2017 dhe nga viti në vit numri i familjeve qe trajtohen me bonus qiraje është në rritje .Për vitin 2023 u trajtuan me bonus qiraje 42 familje me nje vlere prej 5 424 686 leke ku bashkia ka mbuluar vleren prej 3 483 786 leke, ndërsa qeveria 1,940,900 lekë.Ndërsa për vitin 2024 u trajtuan 45 familje me 5,918,820 ku bashkia mbuloi vlerën prej 2,959,410 lekë.

Por kërkesat e shumta për bonus strehimi shoqërohen me vështirësi, për gjetjen e banesave në tregun e lire edhe pse ka shumë banesa bosh ,pronarët e tyre hezitojnë ti japin me qira , pasi nuk kanë besim te qiramarrësit se ata do të jenë korekt në pagesat e konsumimit të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm dhe hezitojnë nga pagesa e tatimit në vlerën 15% të çmimit të kontratës së qirasë/ mujore edhe pse me ndryshimet qe ju bënë ligjit 22/2018 “Për strehimin social “ me ligjin nr.48/2023, ata përjashtohen nga pagesa e kësaj vlere,pasi kjo vlerë do të subvencionohet nga buxheti i shtetit.

Mbështetur në VKM-në nr.459,datë 3.07.2019 “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin” dhe shkresës nr.15900 prot , dt 18.12.2024 ne duhet të paraqesim pranë MEKI , brenda datës 31.Janar 2025 kërkesat për bonus strehimi, të shoqëruar me kostot financiare për çdo familje dhe listën e detajuar të familjeve përfituese të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Për fillimin e procedurës është e nevojshme miratimi i qirasë mesatare në tregun e lirë ,sipas strukturës së apartamentit, pasi nuk ka akte ligjore apo nënligjore që të përcaktojnë nivelin e qirasë sipas Bashkive .Për sa më sipër ju propozojme miratimin e çmimit mesatar të qirasë në tregut e lire ,të marra gjatë një viti ,sipas strukturës së apartamentit dhe vendodhjes së tij vetëm për struktura 1+1 dhe 2+1,ndërsa për strukture garsoniere nuk kemi sjelle pasi nuk ka struktura në treg te lire q jepen me qira si më poshtë:

1.Për Lagjen Nr.1dhe Nr.3

- Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 13000 – 17000 lekë.
- Për apartamentinme strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 18000 – 22000 lekë.

2.Për Lagjen Nr.2

- Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 15000-18000 lekë.
- Për apartamentin me strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 21000-24000 lekë.

Drejtori
Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E EMERGJENCAVE ,PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHWRBIMEVE

RELACION

MBI MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QE PËRFITOJNË BONUS QIRAJE

Të nderuar Këshilltare !

Në kuadër të mbështetjes dhe zbatimit të politikave të strehimit që Bashkia Berat ofron në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si dhe në zbatim të pikës 34,45 nenit 2, neni 33,34 të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, vkm nr.459, datë 3.07.2019 "Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", për qytetarët në nevojë për t'u strehuar, po ju sjellim listën e kërkesave për bonus strehimi, sipas formatit të kërkuar nga ministria përgjegjëse për strehimin, shoqëruar me kostot financiare për çdo familje dhe listën e detajuar të familjeve përfituese.

Theksojmë se, bazuar në legjislacionin në fuqi, përfitojnë bonus strehimi nga buxheti i shtetit, kategoritë e familjeve të parashikuara në nenin 46, të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social" të cilat janë: kryefamiljarët me aftësi të kufizuara; individë me status të jetimit; kryefamiljarët e vetëm me fëmijë; familjet njëprindërore; vajzat nena; familjet që trajtohen me ndihme ekonomike; familjeve që kanë në përbërjen familjare persona me aftësi të kufizuara dhe invalidë, familjet që trajtohen me ndihme ekonomike si dhe familjet me të ardhura mujore të ulëta. Kusht për përfitimin e fondit të bonusit të qirasë nga buxheti i shtetit është që familjet që do të trajtohen me bonus qiraje, duhet të mbulojnë pjesën e mbetur të qirasë me të ardhurat e tyre, ose nëpërmjet financimit të bashkisë (sipas tabelës bashkëlidhur relacionit).

Komisioni i Strehimit i mbledhur me datë 21.01.2025 pasi mori në shqyrtim të gjitha kërkesat e bëra për bonus strehimi, rezultoi se mbas shqyrtimit të 57 kërkesave u kualifikohen 50 familje, ndërsa 7 kërkesa u s'kualifikuan për mungesë dokumentacioni ose që nuk plotësonin kushtet ligjore për t'u trajtuar me bonus qiraje.

Kërkojme nga ana Juaj miratimin e listës së familjeve të përbërë nga 50 familje që u kualifikuan nga Komisioni i Strehimit.

Bashkëlidhur lista e familjeve përfituese.

Drejtore
Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT**

RELACION

PËR NJË SHITESË NË VKB NR.105, DATË 18.12.2024, "MBI MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARA UNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025"

Të nderuar zotërinj këshilltarë!

Këshilli Bashkiak me vendim nr.105 date 18.12.2024 "Mbi miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin arsimor 2024-2025", ka miratuar listën e nxënësve të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe janë përfitues të bursës si dhe përfitimeve të tjera, të parashikuara në:

- **VKM Nr.666, datë 10.10.2019 të ndryshuar VKM Nr.511, datë 27.7.2022** "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike"

-Bazuar në nenin 33 të **VKM Nr.666, datë 10.10.2019 të ndryshuar VKM Nr.511, datë 27.7.2022** sipas të cilit "Vendimet e këshillave të NJVV, në raste të veçanta, mund të miratohen përtej këtij afati vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin parauniversitar apo për arsimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore përkatëse"

Në Drejtorinë Arsimore, Bashkia Berat janë paraqitur 5 (pesë) kërkesa me 11 (njëmbëdhjet) nxënës aplikantë për përfitimin e bursave shtesë, nga shkollat e mesme të përgjithshme, profesionale dhe ZVA (për një nxënës në arsimin 9-vjecar), kërkesat si më poshtë:

-Kërkesa e ZVAP Berat me nr.33, datë 17.01.2025 "Për një shtë në listën emërore të nxënësve kandidatë për bursë"

-Kërkesa e shkollës profesionale "Stiljano Bandilli" me nr.34, datë 20.01.2025.

-Kërkesa e shkollës së mesme të përgjithshme "Kristaq Capo" me nr.39, datë 20.01.2025.

-Kërkesa e shkollës së mesme profesionale "Kristo Isak" me nr.39/1, datë 21.01.2025.

-Kërkesa e shkollës së mesme të përgjithshme "Babë dudë Karbunara" me nr.39/2, datë 21.01.2025.

Gjithashtu duke u mbështetur në:

➤ Në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit protokolluar me tonen nr.684 prot, datë 25.11.2024 "Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit, të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2024-2025" (**80 bursa në total**), nga këto kemi ende të lira dhe 3 (tre) kuota.

➤ Në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë protokolluar me tonën nr.646 prot datë 04.11.2024 "Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2024-2025" (**60 bursa për nxënësit e klasave të X-ta**), nga këto kemi ende të lira dhe 9 (nëntë) kuota.



Komisioni i bursave shqyrtoi kërkesat dhe paraqet pranë Këshillit Bashkiak miratimin e bursës së plotë për nxënësit si vijojnë sipas kriterëve përkatëse:

- 1- Anxhelo Xhevair Sakaj shkolla e mesme profesionale “Stiliano Bandilli”, në klasën e XI-të, aplikant për bursë sipas kriterit ekonomik pika 2.1.a.
- 2- Sara Syrja Sinaraku shkolla e mesme profesionale “Stiliano Bandilli”, në klasën e XII-të, aplikante për bursë sipas kriterit ekonomik pika 2.1.a, ish përfituese për vitin e shkuar.
- 3- Ujgen Aleksander Lilaj shkolla e mesme profesionale “Stiliano Bandilli”, në klasën e X-të, aplikant për bursë sipas kriterit jo ekonomik pika 2.3 g “Nxënësit me një prind, kur njëri nga prindërit nuk jeton”.
- 4- Sabiela Klodian Vrapit shkolla e mesme përgjithshme “Kristaq Capo”, në klasën e XI-të, aplikant për bursë sipas kriterit jo ekonomik pika 2.3 g “Nxënësit me një prind, kur njëri nga prindërit nuk jeton”.
- 5- Mirela Taulant Plaku shkolla 9-vjecare “28 Nëntori” kriteri ekonomik 2.1 c “Nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë”.
- 6- Tana Naun Sylari shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, aplikant për bursë sipas kriterit ekonomik pika 2.1.a.
- 7- Azbi Nexhip Shkurti shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, aplikant për bursë sipas kriterit ekonomik pika 2.1.a.
- 8- Klea Ermir Mjeshtri shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, aplikant për bursë sipas kriterit ekonomik pika 2.1.a.
- 9- Arsen Verlind Troka shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, aplikant për bursë sipas kriterit ekonomik pika 2.1.a.
- 10- Vesjana Ilirjan Hysa shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”, në klasën e X-të, aplikant për bursë sipas kriterit jo ekonomik pika 2.3. gj “Nxënëset, të cilat regjistrohen për herë të parë në arsimin profesional në të gjitha drejtimet mësimore, përjashtuar ato që përfitojnë nga shkronja “F”, e këtij vendimi, trajtohen me 50% të bursës”
- 11- Pietro Luciano Boce shkolla e mesme e përgjithshme “Babë Dudë Karbunara”, në klasën e X-të, aplikant për bursë sipas kriterit ekonomik pika 2.1.a.

- Në perfundim të procesit u vendos që të propozohen për miratim të bursës së plotë 11 (njëmbëdhjtë) nxënës aplikantë nga shkollat e mesme profesionale, të mesme të përgjithshme dhe arsimit 9-vjecar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

MBI MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027
BASHKIA BERAT

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat, si një ndër prioritetet e saj, ka mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me hartimin, programimin dhe zhvillimin e politikave vendore dhe projekteve konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së rinisë, duke nxitur shtimin dhe zgjerimin e shërbimeve dhe integrimin e të rinjve në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 24, neni 25; Ligjit nr. 75/ 2019 “Për Rininë”, neni 7, pikat c, ç, d, e; “Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029”; ka hartuar Planin Lokal të Veprimit të Rinisë 2025-2029 të Bashkisë Berat, në përputhje me legjislacionin, strategjitë dhe standardet kombëtare të çështjeve rinore, si dhe prioritetet e përcaktuara nga bashkia për t’iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme dhe cilësore nevojave në rritje të këtij komuniteti.

Ky është plani i parë lokal i veprimit për rininë që Bashkia e Beratit harton. Në mënyrë të vazhdueshme e të qëndrueshme, strukturat përgjegjëse për punën me dhe për të rinjtë në Bashki, kanë hartuar politika, programe dhe aktivitete formale dhe joformale në mbështetje të rritjes së kapaciteteve dhe mirëqënies së të rinjve e në zbatim të orientimeve kombëtare e ndërkombëtare; por ky Plan Lokal i Veprimit për Rininë është një dokument zyrtar, një instrument që synon të drejtojë dhe orientojë në mënyrë të strukturuar e koordinuar punën e strukturave të angazhuara me dhe për të rinjtë, komunitetin, ofruesit e shërbimeve për të rinjtë dhe palët e tjera të interesuara; për të plotësuar nevojat e të rinjve të Bashkisë Berat dhe për të ofruar shërbime me qasje miqësore kundrejt të rinjve.

Plani është rezultat i një procesi konsultimi që përfshiu seminare, takime dhe intervista, si dhe një anketë me të rinjtë. Plani është strukturuar përreth objektivave të vendosura për arritjen e prioriteteve - organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore; mirëqenia aktive fizike dhe mendore e të rinjve; dhe aftësimi dhe punësimi rinor.

Në fazën e parë u shqyrtua legjislacioni aktual, veçanërisht i Ligjit “Për rininë”, Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, i Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe dokumenteve të tjera strategjike

që lidhen me rininë. Më pas u sigurua përfshirja e të rinjve për identifikimin e nevojave, shqetësimeve dhe problematikave të tyre. Të rinjtë e përfshirë ishin përfaqësuesit e Këshillit Vendor të Rinisë të Bashkisë Berat, të rinjtë e angazhuar në aktivitetet e Qendrës Multifunkionale Rinore Berat, shoqatës rinore Ura të Reja etj. U identifikuan fusha prioritare dhe u vendosën në bazë të strukturës së këtij plani që janë organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore; mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale e mendore e të rinjve; aftësimi dhe punësimi i të rinjve. Hapi tjetër konsistoi në konsultimin me strukturat e bashkisë dhe aktorët e tjerë lokalë lidhur me problematikat për rininë dhe zgjidhjen e tyre. Në këtë kontekst, u zhvilluan takime me personat përgjegjës të strukturave përgjegjëse, sidomos stafin e Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Rinisë në Bashkinë Berat dhe të Qendrës Rinore Berat, u identifikua gjendja ekzistuese lidhur me politikat dhe burimet lokale për plotësimin e nevojave të rinisë, mangësitë dhe potencialet dhe në fund u hartua Plan i Veprimit për Rininë 2025-2027 me linjat e përgjithshme si vijon:

Vizioni *“Të rinjtë, e sotmja dhe e ardhmja e komunitetit beratas”.*

Misioni *“Fuqizimi i të rinjve nga e gjithë Bashkia e Beratit për pjesëmarrje aktive dhe kontribut në vendimmarrjen lokale, punësim për realizimin e ambicieve rinore dhe një jetesë aktive dhe të shëndetshme.”* 16

Tre fushat prioritare:

- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në vendimmarrjen lokale

Qëllimi 1:

Të rrisim kapacitete për një pjesëmarrje cilësore dhe efektive të të rinjve në proceset lokale

Objektiva Specifike 1.1: Të rrisim kapacitetet për një pjesëmarrje cilësore dhe efektive të të rinjve në proceset lokale.

Objektiva Specifike 1.2: Të krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrje rinore aktive dhe cilësore.

- Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve.

Qëllimi 2:

Të rrisim mundësitë për një jetë aktive, të shëndetshme fizike, sociale dhe mendore të të rinjve të Bashkisë Berat.

Objektiva Specifike 2.1: Të rrisim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitetet sociale, kulturore, artistike dhe sportive.

Objektiva Specifike 2.2: Të përmirësohen shërbimet që mundësojnë një jetesë të shëndetshme të të rinjve.

- Aftësimi profesional dhe punësimi i të rinjve

Qëllimi 3:

Integrimi i të rinjve në tregun e punës.

Objektiva Specifike 3.1. Rritja e informimit të të rinjve lidhur me mundësitë për aftësim profesional dhe punësim/vetëpunësim dhe përmirësimi i këshillimit të karrierës për të rinjtë.

Objektiva Specifike 3.2: Të rrisim mundësitë e të rinjve për të marrë aftësim profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës në Bashkinë Berat.

Bashkëngjitur gjeni Planin Lokal të Veprimit të Rinisë 2025-2029.

Drejtori

Majlinda Ramaj

